

Deleted Items [n] ose Trash (n)	Ruhen per nje periudhe limit emaillet e fshira ku [n] ose (n) tregojne numrin e emaileve te palexuara
Junk E-mail [n] ose Junk (n)	Ruhen emaillet e padeshiruara, te ardhura nga adresa te panjohura ku [n] ose (n) tregojne numrin e emaileve te palexuara
Folder [n] ose Folder (n)	Direktori te krijuara dhe emertuara sipas preferences se perdoruesit ku [n] ose (n) tregojne numrin e emaileve te palexuara

1.5.7 Mesazhi Elektronik dhe Ndertimi i tij

Qellimi kryesor i sistemeve te postes elektronike eshte te sigurojne dergimin e mesazhit elektronik. Nje mesazh elektronik perbehet nga: koka, trupi dhe skedaret shtese (email attachments). Perpara se te shohim ndertimin e nje mesazhi elektronik, fillimisht le te permbledhim veprimet qe kryhen mbi te. Veprimet jane ne dy forma: komanda (Per nderfaqet me komanda) dhe kontrole perdoruesi (Per nderfaqet grafike). Ne tabelen vijuese paraqiten disa veprime perdoruesish te njohura per te gjitha email klientet.

Ekzistojne dy tipe mesazhesh elektronike ne varesi te formatit ne te cilat ato dergohen: *Plain text* dhe *HTML*. Formatimi *plain text* eshte me i thjeshte dhe me i sigurte sesa formatimi HTML, i cili pavaresisht se ofron stile te ndryshme formatimi dhe e pasuron mesazhin me figura te animuara si *emotions*, ai shpesh njihet si nje format jo i sigurte per dergim mesazhesh elektronike si dhe shton konsiderueshem madhesine ne byte te mesazhit.

Me mesazhin elektronik kryhen veprime te shumta te cilat perfaqesojne funksionalitetet e email klientit perkates. Veprimet e pergjithshme me mesazhin elektronik jepen ne Tabelen 3.

Tabela 3 – Veprimet me Mesazhet Elektronike dhe Funksionet perkatese

<i>Veprime me Mesazhet Elektronike dhe Funksionet e tyre</i>	
<i>Veprimi</i>	<i>Funksioni</i>
New/Compose/Write	Krijohet nje mesazh i ri
Send	Dergohet mesazhi
Print	Printohet ne hardcopy mesazhi i perzgjedhur
Reply	Kthehet pergjigje apo replike email derguesit Ne fushen Subject rreshti do te paraprihet nga "Re:" Rreshtat e trupit te mesazhit do te paraprihen nga karakteri ">"
Reply to All	Kthehet pergjigje apo replike te gjitha email derguesve prezente ne listen e marresve
Forward	Pasohet mesazhi i marre

	Ne fushen Subject rreshti do te paraprihet nga "Fwd:" Rreshtat e trupit te mesazhit do te paraprihen nga karakteri ">"
Save to Drafts/Folders	Ruhet mesazhi/et e perzgjedhura ne direktorine Drafts ose ne direktori te tjera
Delete/Remove/Erase	Fshihet mesazhi/et e perzgjedhura
Spam	Email derguesi i mesazhit te perzgjedhur do t'i shtohet listes se zeze (black-list) se perdoruesve te padeshiruar dhe ne vijim ato automatikisht do te dergohen ne direktorine Junk apo Spam
Attach	Ngarkimi i skedareve shtese nga disku

Sikurse u permend me siper, nje mesazh elektronik i pakoduar perbehet nga: koka (*header*), trupi ose permbajtja (*body*) dhe skedaret shtese (*email attachments*). Nje liste e plote informuese dhe fushat perberese te nje mesazhi elektronik identifikohen duke pare *Message Source* per ate mesazh. Ne po paraqesim nje liste te reduktuar me fushat perberese te nje mesazhi elektronik (disa prej te cilave jane te dukshme ne formen e kontrollit perdoruesish) dhe funksionet e tyre si ne Tabelen 4.

Tabela 4 – Disa fushat te nje Mesazhi Elektronik dhe Funksionet perkatese

<i>Koka e Mesazhit (Header)</i>	
Fusha	Funksioni
From (E detyrueshme)	Mban adresen e derguesit te mesazhit Mban adresen e krijuesit te Mailing List dhe ne rastin e ndonje gabimi, mesazhi i kthehet krijuesit te listes dhe jo derguesit origjinal Adresa ne kete fusha mudn te kufizohet prej "< >"
To (E detyrueshme)	Adresa/t e marresve te cileve u drejtohet mesazhi drejtperdrejte Adresat jane te dukshme Adresat ndahen me presje ',' nga njera tjetra
Cc (Carbon Copy) (Opsionale)	Adresa/t e marresve te cilat do te marrin nje kopje te mesazhit Adresat jane te dukshme Meqenese numri i adresave ne fushen To eshte i kufizuar perdoret edhe fusha Cc per te mbajtur nje pjese te adresave Adresat ndahen me presje ',' nga njera tjetra
Bcc (Blind Carbon Copy) (Opsionale)	Adresa/t e marresve te cilat do te marrin nje kopje te mesazhit Adresat ne Bcc jane te padukshme nga njera tjetra dhe nga marresit ne fushat To dhe Cc Adresat ndahen me presje ',' nga njera tjetra
Mailing List	Komandat Subscribe – Per t'u regjistruar ne mailing list

(Opsionale)	Komanda Unsubscribe – Per t'u ç'rregjistruar nga mailing list Komanda Help – Per t'u informuar rreth komandave te mailing list
Date (E detyrueshme)	Data dhe ora e dergimit te mesazhit nga email serveri
Received. (Opsionale)	Informacione rreth serverave ndermjetes dhe dates se procesimit te mesazhit Mesazhet mund te kalojne nepermjet serverave ndermjetes deri ne serverin destinacion
In-Reply-To (Opsionale)	Adrese te ciles i kthehet pergjigje apo replike Kjo adrese eshte preferencialisht adresa e fushes From
Message-ID (Opsionale)	Numer i vetem identifikues i çdo mesazhi
X-Spam-Status (Opsionale)	Softwaret Anti-Spam u vendosin mesazheve te padeshiruara header-in X-Spam-Status: Yes
X-Mailer (Opsionale)	Çdo fushe qe fillon me X vendoset nga vete sistemi per te identifikuar software-in e perdorur per te derguar mesazhin
Subject (E detyrueshme)	Subjekti apo titulli i mesazhit qe do t'u shfaqet email marresve
Trupi i Mesazhit (Body)	
Message (Opsionale)	Grup karakteresh alfanumerike (mesazhi tekst qe dergohet) ose mund te jete dhe bosh (asnje karakter)
Signature (Opsionale)	Rreshta teksti qe do te shfaqen ne fund te çdo mesazhi te derguar prej perdoruesit
Skedaret Shtese (Email Attachments)	
Attachments (Opsionale)	Skedare bashkangjitur mesazhit elektronik; jane te tipit: Audio, Video, Tekst, Imazh

2.1 Komunikimi me Poste Elektronike

Pavaresisht lehtesise qe ofron perdorimi i sistemeve te postes elektronike, mekanizmi i punes se tyre konsiderohet kompleks. Skema e punes do te paraqitet si ne Figuren 12.




Figura 12 – Skema e Punes ne Sistemet e Postes Elektronike

Fillimisht le te identifikojme e percaktojme komponentet kryesore te skemes dhe me pas te sqarojme hapat e punes ne te:

1. MUA (Mail User Agent)

Njihet ndryshe si email klient. Eshte nje software pergjegjes per menaxhimin e postes elektronike dhe bashkerendimin e proçeseve ne anen e klientit si dhe ndervepron me email servera per te shkëmbyer mesazhe elektronike. Nje MUA perzgjedh per te derguar mesazhin elektronik drejt nje MTA ose MSA – dy *outgoing mail servera* qe perdorin protokollin SMTP por operojne ne porta te ndryshme. Emaili qe dergohet quhet **Outgoing Mail** ndersa ai merret quhet **Incoming Mail**.

2. MTA (Mail Transport Agent)

Eshte serveri i emaileve qe dergohen. Ne pergjithesi, MTA (ose SMTP MTA) i email derguesit ia pason mesazhin MTA-se se email marresit i cili e drejton mesazhin ne mailboxin destinacion. Pra, MTA luan funksionin e nje ure lidhese ne komunikimin e email serverit te derguesit dhe atij te email marresit. MTA-te komunikojne nepermjet protokollit SMTP ndaj ato njihen si **Servera SMTP** ose **Outgoing Mail Servers**. MTA sherben per transportim mesazhesh emaili.

3. MSA (Mail Submission Agent)

MSA ose SMTP MSA eshte nje variacion i MTA-se; porta e tij ndryshon nga ajo default pra e SMTP ose MTA. RFC 4409 percakton standartet per perdorimin e MSA-se. Ne Tabelen 5 me poshte jepen portat e komunikimit per MSA dhe MTA:

Tabela 5 – Portat e komunikimit per MTA dhe MSA

Protokolli	Email	Mesazh Plain Text ose i Shifruar (Porta)	Mesazh Plain Text (Porta)	Mesazh i Shifruar (Porta)
MTA	Outgoing	25		465
MSA	Outgoing	587		

4. SMTP (Simple Mail Transfer Protocol)

Protokolli per dergimin e mesazheve te emaileve.

- Çdo emaili qe do dergohet do t'i bashkangjitet nje *SMTP header*
 - › SMTP Header permban: *host name* dhe *timestamp*
- Komunikimi behet nepermjet TCP ne porten 25
 - › Email Klienti ia trasmeton mesazhin Serverit SMTP default
 - › *SMTP Header* ndryshon (updatehet) pas çdo "ndalesë" procesimi qe ben ne email serverat ndermjetes derisa te mberrije ne email serverin destinacion
 - › *SMTP MTA* (Serveri dergues SMTP) komunikon dhe trasmeton mesazhin tek *SMTP MSA* (Serveri marres SMTP)
 - › Perdoret sherbimi DNS per te marre adresen IP te *SMTP MSA*
 - › *SMTP MSA* mund t'ia pasoje mesazhin e marre nje serveri tjeter

5. DNS Server (Domain Name System Server)

Eshte nje sherbim qe perkthen hostname ne adresa IP dhe anasjelltas. Ne skemen e punes se SPE-ve, DNS Server u pergjigjet kerkesave te *Root NameSpace Domain* dhe ia percjell kerkesat per *TLD* (Top Level Domain), Name Serverave te TLD-ve perkatese. Nga Nameserverat e TLD-ve perkatese, rezultatet grumbullohen ne formen e nje *MX Record*. DNS Server pergjigjet me *MX Record* (Mail Exchange Record) – duke listuar te gjithe mail

exchange serverat qe pranojne email nga nje adrese e caktuar; adresa apo adresat ne fushat e marresve te mesazhit. Shihni skemen e DNS Serverave ne Figuren 13 :




Figura 13 – Name Servera te gjeneruar me TLD .edu dhe .al

6. MS Record (Mail Exchange Record)

Mail Exchange (ME) i referohet hostit (kompjuterit), roli primar i se ciles eshte marrja dhe dergimi i emailit. ME njihet gjithashtu si *mailhost*, *mailhub*, ose *postoffice* dhe ka te instaluar hje software qe luan funksionin e email serverit e qe perdor porten 25. Nje MX Record do te ridrejtoje nje email qe eshte destinuar per nje perdorues (shembull: dekan@fit.uamd.edu.al) tek nje mailhost. Ne menyre te permbledhur, MX Record i tregon MDA-se se ku duhet drejtuar (routuar) emaili; ai perdor vlera preferenciale per te specifikuar rendin e routimit (vlera me e vogel shpreh prioritetin me te larte). Ne shembullin e meposhtem, kur emaili eshte derguar per tek fit.uamd.edu.al, MDA-ja perpiqet ta ridrejtoje emailin tek mailhost.fit.uamd.edu.al e cila ka vleren me te vogel, pra prioritetin me te larte. Nese ky veprim deshton, atehere emaili ridrejtohet tek mailhost2.fit.uamd.edu.al dhe nese veprimi rideshton, emaili dergohet perfundimisht tek mailhost3.fit.uamd.edu.al. Shembulli ne vijim ilustron sa thame me lart:

fit.uamd.edu.al	86400	A		128.253.180.254
fit.uamd.edu.al	86400	MX	10	mailhost.fit.uamd.edu.al
fit.uamd.edu.al	86400	MX	20	mailhost2.fit.uamd.edu.al
fit.uamd.edu.al	86400	MX	30	mailhost3.fit.uamd.edu.al

❖ MX Record per Hostet Joekzistuese

Nje MX record mund te funksionoje edhe ne rastet e hosteve qe nuk jane te regjistruara (ekzistuese) ose jo me te regjistruara (jo me ekzistuese). Shembull: Nese perdoruesi dekan ka marre dhe derguar email per nje kohe te gjate nepermjet adreses `dekan@fit.uamd.edu.al`, pavaresisht se hosti fit do te dale jashte perdorimit, perdoruesi dekan mund te vazhdoje te marre email ne adresen e tij te vjeter. Kjo realizohet nese ka nje MX Record per hostin fit i cili ridrejton emailin tek nje adrese ekzistuese e perdoruesit dekan.

❖ MX Record per Domain-et

Nje MX Record i ketij lloji, do ta ridrejtoje emailin derguar tek adresa `dekan@fit.uamd.edu.al` tek nje mailhost. Shembull: Nese ekziston nje MX Record domaini per `fit.uamd.edu.al`, qe ka mail exchange (email server): `mailhost.fit.uamd.edu.al`, atehere emaili i destinuar per tek `dekan@fit.uamd.edu.al` do te dergohet tek `dekan@mailhost.fit.uamd.edu.al`.

Nga ana tjeter, ekzistojne MX Record-e per çdo host te regjistruar ne nje domain. Kjo menyre funksionimi ka avantazh sepse emaili do te dergohet ne nje mailhost qendror ne rast se hostet e konfiguruaruara keq, do te dergonin nje pergjigje emaili ne nyjen (kompjuterin) lokal. Shembull: Nese ekziston nje MX Record domaini per `fit.uamd.edu.al`, qe ka nje mail exchange (email server): `mailhost.fit.uamd.edu.al`, atehere emaili i destinuar per tek `dekan@fit.uamd.edu.al` do te dergohet tek `dekan@mailhost.fit.uamd.edu.al`.

7. MDA (Mail Delivery Agent)

MTA-ja e email marresit ia dorezon mesazhin MDA-se te email marresit. Ky eshte nje software i cili pasi analizon koken e mesazhit (message header), ose vendos ta lere ate ne mailbox ne nyjen ku po operon (nga ku email marresi ta lexoje) ose ta ktheje mbrapsht e ta ridrejtoje ne ndonje nyje tjeter. MDA njihet edhe si **Incoming Mail Server**. Perdoren dy protokolle per te marre emaillet qe ruhen ne MDA: POP3 dhe IMAP4. Ne varesi te protokollit te perdorur Incoming Mail Servers jane dy llojesh: POP Servera dhe IMAP Servera. MDA luan rolin e mailbox-it i cili ruan mesazhin. Per te ruajtur konfidencialitetin e informacionit perdoren kredencialet:

login (emri i perdoruesit) dhe **password** (fjalekalimi). Marrja dhe leximi i emailit behet nepermjet nje MUA: Mozilla Thunderbird, MS Outlook, Lotus Notes, etj.

8. POP3 – Post Office Protocol 3

Protokolli POP3 eshte me i vjeter se protokollit analog IMAP4. Portat e tij jane 110 ose 995 ne varesi te tipit te mesazhit. Ky protokoll i lejon email klientit: t'i shkarkoje mesazhet nga nje dhe t'i fshije mesazhet ne email server vetem pasi ato te jene ruajtur me sukses ne harddiskun lokal. Mesazhet mund te lihen ne email server me qellim qe ato te shkarkohen dhe nga ndonje klient tjeter. Protokolli konsiderohet primitiv edhe sepse nuk vendos flamuj (flagging) per te njoftuar nese mesazhi eshte lexuar ose jo; nese i eshte kthyer pergjigje email derguesit apo i eshte pasuar ndonje email marresi tjeter. Per kete arsye, POP nuk eshte i dobishem per perdoruesit qe aksesojne te njejtin email nga nyje (kompjuteri) te ndryshme. Shkurtime:

- Klienti POP3 (Email Klienti qe perdor protokollin POP3) lidhet me email serverin dhe:
 - › Shkarkon kopje te mesazheve te emailit
 - › Mesazhet fshihen ose lihen ne email server per t'u lexuar nga nje klient tjeter
- Klienti ruan informacion rreth mesazheve te ardhura ne mailbox

9. IMAP4 – Internet Message Access Protocol 4

Ne te kundert, protokollin IMAP4 u jep mundesi perdoruesve t'i ruajne mesazhet ne email server, duke u vendosur flumuj sipas veprimit te kryer mbi mesazhin. Ne sistemet e konfiguruar me IMAP4, automatikisht krijohen direktorite *Sent*, *Drafts*, dhe *Trash*. Nje prej karakteristikave te IMAP4 eshte krijimi i nendirektorive. Shkurtimisht:

- Perdoruesi mund te lidhet me Klientin IMAP4 nga nje (kompjutera) te ndryshme
- Mesazhet ruhen ne email server
- Klienti mund te:
 - › Shikoje listen me vetem kokat e mesazheve (message headers)
 - › Shikoje permbajtjen (body) e mesazheve specifiket
 - › Kerkoje per permbajtjen e mesazheve
 - › Zhvendose mesazhet ne direktorite e mailbox-it

Tabela 6 – Portat e komunikimit per POP3 dhe IMAP4

Protokolli	Email	Mesazh Plain Text ose i Shifruar (Porta)	Mesazh Plain Text (Porta)	Mesazh i Shifruar (Porta)
POP3	Incoming	110		995
IMAP4	Incoming	143		993

2.2 Proçeset me Mesazhet Elektronike

Komponentet e lartpermendur bashkerendojne veprimet me komponente te tjere ndermjete per te kryer tre proçese me mesazhet elektronike:

1. Formatimi i mesazhit

Zakonisht, MUA apo Email Klientet ofrojne utilitete apo funksione per te shkruar e formatuar tekstin e mesazheve. Alternative mund te ishte perdorimi i nje editorit te jashtem. Funksionet e formatimit te mesazheve nga MUA percaktohen nga standartet RFC 5322: per kokefi (fushat e se ciles pajisen me adresa nga libri i adresave elektronike (address books) qe ruhen ne Serverat LDAP (pergjegjese per to) dhe trupin (permbajtjen) e mesazheve.

Ndersa protokollimi MIME përgjigjet për formatimin e përmbajtjes jotekstuale të ndryshme multimediale (audio, video, imazhe) dhe të skedareve shtese (email attachments).

2. Dërgimi i mesazhit

Një MUA përzgjedh për të dërguar mesazhin elektronik drejt një serveri MTA ose MSA. Email Klienti ka për qëllim të dërgojë mesazhin pa marrë në konsideratë se ku dhe si do të vendoset mesazhi. Agjenti i dërgimit të mesazhit ka përgjegjësi ta çojë atë deri në serverin destinacion. Automatikisht email klientet lidhen me email serverat në mënyrë preferenciale (me të cilët janë lidhur përherë). Nga ana tjetër, email serverat përdorin mekanizma për të përcaktuar nëse duhet të marrin mesazhe nga disa email kliente. Ekzistojnë dy mekanizma të tilla:

- **Mekanizmi me i hershem** përdor sistemin e bazuar mbi njohuritë: dallon adresën IP të email klientit dhe arsye të dy: klienti lidhet gjithmone nga e njëjta makine (adresa e brendshme është gjithnjë 127.0.0.1), ose adresa IP e klientit përkon me të njëjtin ISP (Internet Service Provider - kompani që i ofron klientit shërbime interneti dhe emaili). **Mekanizmi me i ri** bazohet mbi faktin se protokollimi SMTP ka një prapashtesë që e identifikon klientin. Nga ana e klientit (client side), duhet të merret informacion rreth: emrit ose adresës IP të Outgoing Mail Server të përzgjedhur, numrit të portës së komunikimit (MTA përdor automatikisht portën 25, MSA përdor portën 587) dhe kredencialet (username dhe password) nëse ka të tilla, për t'u identifikuar në email server. Protokollimi SMTP përdor portën jo standarte 465 për transmetimin e mesazheve të koduara sipas SSL (Secure Socket Layer). Ndersa përdorimi i portave standarte për mesazhet e shifruara me TLS (Transport Layer Security) bëhet i mundur nëse email klientet dhe email serverat e suportojnë (lejojnë) TLS-në.

3. Marrja e mesazhit

MUA-të janë aktive vetëm gjatë kohës kur përdoruesi është duke punuar në të pra programi klient është duke u ekzekutuar. Mesazhet mbërrijnë në MTA Server dhe ruhen atje derisa MUA të aksesojë mailboxin me kërkesë të përdoruesit (kërkesa përkethehet në formën e klikimit të një butoni ose hiperlinku, dhenies së një komande në një terminal, etj).

Skema e punës përmbledhet në katër hapa:

1. MUA_A formaton sipas një protokollimi shifrimi (të përcaktuar) mesazhin elektronik dhe nëpërmjet protokollit SMTP ia dërgon mesazhin MTA-së lokale (smtp.a.org), e cila mbikqyret nga ISP -ja (Internet Service Provider) e përdoruesit A.
2. MTA analizon adresën e destinacionit me ndihmën e MTA-së lokale (kjo mundësohet nga SMTP Header - bob@b.org). Adresa ka formatin që kemi përmendur:
 1. localpart@exampledomain.com – adresë emaili në internet e cila njihet si *Fully Qualified Domain Address (FQDA)*
 2. localpart - emri i përdoruesit (username) ose mailbox-i

3. exampledomain – domain-i (domain name).

MTA komunikon me shërbimin DNS (*Domain Name System*) për të gjetur Mail Exchange Serverat (email serverat) që pranojnë emailë nga kjo adresë .

3. **DNS Server (ns.b.org)** – i cili është Name Server që i përket domain-it **b.org**, i përgjigjet MTA-se me një **MX Record (Mail Exchange Record)** – duke listuar të gjithë **mail exchange serverat** (email serverat) që pranojnë email nga adresa **mx.b.org**, një server që mbikqyret nga ISP-ja e përdoruesit B.
4. **smtp.a.org** i dërgon mesazh **mx.b.org** me protokollin **SMTP**, i cili bën të mundur transmetimin e mesazhit drejt mailboxit të përdoruesit B.

Frida Gjermeni

3.1 Protokollet e Postes Elektronike

3.1.1 Protokollit SMTP (Simple Mail Transfer Protocol).

Deri me tani jane diskutuar MTA-te dhe roli i tyre ne transferimin e mesazheve elektronike ndermjet email klientit dhe email serverit. Rrjedhimisht MTA-te do te jene 2 llojeshe: MTA Client (MTA per Klientin) dhe MTA Server (MTA per Serverin). Protokollit qe perdoret nga MTA Client dhe MTA Server eshte SMTP (Simple Mail Transfer Protocol). MTA Server me ane te komandave (*Commands*) ben kerkesa tek MTA Server, i cili pergjigjet me *Responses*. Fillimisht, protokollit SMTP eshte percaktuar ne vitin 1982 sipas standarteve RFC 821. Ripercaktimi i tij eshte bere edhe ne 2001 sipas standarteve RFC 2821. Ky protokoll sherben vetem per transferimin e emaileve midis llogarive te perdoruesve. Porta standarte e komunikimit eshte 25. Eshte protokoll *text-based* qe do te thote se perdoruesi ndervepron me protokollit nepermjet utilitetit telnet ne nje nderfaqe komandash (shell) duke shkruar rreshta komandash (commands) dhe duke marre pergjigje (responses) zakonisht te identifikuara nga kodet perkatese. Nje liste e detajuar me komandat dhe pergjigjet te protokollit SMTP do te jepen ne tabelat qe vijojne. Ne sistemet e shfrytezimit te llojit UNIX, komanda *mailx* me ane te opsionit *-v* (verbose: ne menyre te zgjeruar) ben te mundur te vizualizosh hap pas hapi cdo nderveprim (kerkese-pergjigje) midis perdoruesit dhe nje SMTP Serveri ne formen e rreshtave komande.

Tabela 7 – Disa Komanda te Protokollit SMTP

KOMANDA	EMRI I PLOTE	KUPTIMI
HELO	Introduction	Nis komunikimin midis hosteve (sesionin SMTP)
EHLO	Introduction (extended SMTP mode)	Perdoret ne versionin me te detajuar te SMTP-se; Nis komunikimin midis hosteve
RSET	System Reset	Nderpret dhe rivendos automatikisht komunikimin
EXPN	Expand Mailing List	Me ndihmen e SMTP Server, afishohet adresa destinacion per cdo email qe dergohet nje adrese te specifikuar
NOOP	No Operation	Komanda nul. Nuk kryen asnje funksion
VERB	Verbose mode	I pergjigjet nje mesazhi te derguar me opsionin verbose (ne forme te zgjeruar)
MAIL	Specify Mail Sender	Specifikon email derguesin
TURN	Mail Turn	Nxjerr emailet nga rradha ne SMTP Server dhe i ridrejton ne hostin (sipas domainit te specifikuar) qe nisi sesionin SMTP
ETRN	Extended Turn	Nxjerrja dhe ridrejtimi i emaileve drejt hostit behet duke analizuar MX Record e domainit te specifikuar. Kjo komande nuk-zbatohet nga te gjitha versionet e SMTP
RCPT	Specify Mail Recipient	Specifikon email marresin
HELP		Afishon ndihmen elektronike
DATA	Specify Message Content	Specifikon permbajtjen e mesazhit
VERFY	Verify Address	Verteton me ndihmen e SMTP Server vlefshmerine e adreses se specifikuar me qellim evitimin e listave spam
DSN	Delivery Status Notifications	Njofton rreth dergimit me sukses ose jo te mesazhit
QUIT	Quit	Mbyll sesionin SMTP (komunikimin midis hosteve)